

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Energji, projekti 1.2 miliardë euro kalon fazën mjedisore për 366 MW eolikë në Tropojë
ADRESA	https://www.cna.al/ekonomi/energji-projekti-12-miliarde-euro-kalon-fazen-mjedisore-per-366-mw-eolik-i473625
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:24:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 20:26:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ab1240d3649b43b606bf0e1d74c978e5078a4f2a9d09af83ba7b133fc2fb2a40
TEKSTI	2675102aeed17a02d9ea9dce8fb61c77ef89fbba7cad5ad3f19510fd6a1d20b5
PAMJA	4b3d2bc8e462f9b861c08e2ec18e33f017c2cd5014a49806fffc14199860075c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	604edde2665823a0aa32818537ed55511c12c2b324912d88d0507ba0805579ef
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/604edde2665823a0aa32818537ed55511c12c2b324912d88d0507ba0805579ef>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

21:06 Aktualitet

Plarent Ndreca ka zbuluar se ekziston një pushtet tjetër p...

Energji, projekti 1.2 miliardë euro kalon fazën mjedisore për 366 MW eolikë në Tropojë



8 Shtator 2026, 22:26, Ekonomi CNA



Projekti energjetik prej 1.2 miliardë eurosh i "Eralb Invest 2" në Tropojë ka kaluar një tjetër fazë të procedurave, duke marrë deklaratën mjedisore për një park eolik me kapacitet të instaluar 366 MW.

Deklarata është lëshuar më 15 korrik 2026 për projektin "Parku Eolik Tropojë", që parashikon instalimin e 60 turbinave me fuqi 6.1 MW secila. Prodhimi neto i parashikuar është 713.5 GWh energji elektrike në vit.

Ky zhvillim lidhet me projektin më të gjerë të "Eralb Invest 2", të prezantuar si një investim kompleks në energjinë e rinovueshme me vlerë rreth 1.2 miliardë euro.

Projekti ka pasur statusin "Projekt me Potencial Stratejik" ku parashikonte një park eolik prej 636 MW me 100 turbina, si dhe një park fotovoltaik prej 100 MW me 418 500 panela.

Regjia ne pakti strategjik, Regjia me shprehur strategji qe parashikon ne pamje me praqe me mny me te shprehur, shprehur nga pamje te shprehur praqe me mny me te shprehur pamje

Deklarata e fundit mjedisore mbulon kapacitetin prej 366 MW dhe përbën një nga hallkat që duhet të kalojë zhvilluesi përpara fazave të mëtejshme të projektit.

Dokumenti sqaron se deklarata mjedisore nuk është leje përfundimtare zhvillimi, por një miratim që i hap rrugë vijimit të procedurave me kusht zbatimin e kërkesave për parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve në mjedis.


Parku do të zhvillohet në territorin e Bashkisë Tropojë, në qarkun e Kukësit. Sipas dokumentacionit, zona ku parashikohet projekti nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura, ndërsa nga vlerësimi i burimeve ujore nuk rezulton konflikt me kërkesat e legjislacionit në këtë fushë.

Bashkia Tropojë ka dhënë gjithashtu miratimin në parim për zhvillimin e parkut, duke e konsideruar atë një projekt me interes për zhvillimin energjetik dhe ekonomik të zonës. Në korrik është zhvilluar edhe konsultimi publik me banorët dhe përfaqësues të institucioneve vendore e mjedisore.

Projekti ka kaluar ndërkohë në disa faza rikonfigurimi dhe procedurash. Në vitet e mëparshme, zhvillimi i tij ishte ngadalësuar edhe nga çështjet e sipërfaqeve të marra me qira për matjet dhe zhvillimin e parkut eolik.

Pas rishikimit të ngastrave, u lidh një kontratë e re qiraje për 39.02 hektarë me afat 10-vjeçar, ndërsa statusi strategjik i projektit u shty për t'i dhënë kompanisë kohë për plotësimin e procedurave të nevojshme.

Deklarata mjedisore e korrikut, ndërkohë, i referohet konfigurimit prej 366 MW me 60 turbina. Nëse projekti nuk nis zbatimin në terren brenda dy viteve nga miratimi i deklaratës, dokumenti humbet vlefshmërinë dhe procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të nisë nga e para./Monitor.al





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Inflacioni arriti 3.2% në gusht, rritje më e madhe të ushqimave dhe karburantit

Sheshi "Nënë Tereza" vetëm për këmbësorë, nga parkimi të muzeut, projekti 21 milionë euro i FSHZH

Pagat më të larta të gjeni në Tiranë/ Në qarqe shteti paguan më shumë se privatit

Shqipëria ndërton pa fund, por mbetet e treta në Europë për privimin e rëndë nga strehimi

Kursi i këmbimit, 8 shtator 2026

Bankat dhanë më shumë se 107 mijë kredi në gjysmën e parë të vitit

Zbulohen bashkitë e Shqipërisë që janë më të varurat nga ndërtimi

Rruga e Inteligjencës Artificiale në tregje do të bëhet më e trazuar

Kursi i këmbimit valutor, 7 shtator 2026/ Monedhat e huaja vijojnë rënien

Udhëzues për zgjedhjen e kredisë pa kurthe

Qiraja apo kredia/ Cila po ju kushton më shumë?

7 mënyra për kursim familjar që nisin nga paga

Indeksi Big Mac, si ka ndryshuar fuqia blerëse globale në 40 vjet

Monedhat e huaja shënojnë rënie/ Kursi i këmbimit valutor, 6 shtator 2026

Në rrugët e vendit u shtuan 66.5 mijë makina për 8-mujorin, bien me 10% regjistrimet në gusht

Kompensimi për fëmijët nga DIVA 2025, nisin pagesat pas plotësimit të mangësive në dokumentacion

Euro dhe paundi në minimumin historik/ Kursi i këmbimit, 4 shtator 2026

Shtrenjtohet ndërtimi, pagat rrisin kostot më shumë

Ndryshime për monedhat e huaja/ Kursi i këmbimit për ditën e sotme


KESH rrit importet në verë, blerjet në ankande arrijnë 62 milionë euro

[editorial](#)

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

oninion

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.